

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit e Kukësit,

Të nderuar kolegë,

Ka disa ditë që jemi njohur me projektbuxhetin e shtetit për vitin buxhetor 2022 dhe, të them të drejtën, ndiej zhgënjim, pasi mua, si përfaqësues i banorëve të Tropojës kryesisht, por edhe i atyre të Hasit e Kukësit, ajo që me bie në sy është mungesa e planifikimit të financimit të investimeve nga kjo maxhorancë për qarkun e Kukësit, i cili, siç e kam theksuar edhe herë të tjera, është qarku me nivelin më të lartë të varfërisë dhe emigracionit. Rajoni i Kukësit është i dyti rajon në rang kombëtar që ka popullsinë më të madhe që jeton në zona rurale. Sipas Eurostat-it, 64% e popullsisë së kësaj zone jeton në fshat dhe statistikat tregojnë se numri i të punësuarve në sektorin privat bujqësor ka rënie drastike nga viti në vit. Kjo sepse, po ashtu, investimet në këtë sektor janë shumë të ulëta gjatë qeverisjes së rilindjes. Ky indikator tregon qartë diskriminimin ndaj Tropojës, Hasit e Kukësit, që e kanë bujqësinë e blegtorinë mundësinë e vetme të mbijetesës. Fermerët e këtij qarku janë të fundit krahasuar me qarqet e tjera për sa i përket mbështetjes me grante e subvencione për bujqësinë e blegtorinë. Madje, edhe ajo pak mbështetje që arrin deri në këto zona të varfra, shpërndahe në mënyrë selektive, ku përfituesit listohen sipas bindjes politike, ani pse këta fermerë gjasme jetojnë në qytetin e Bajram Currit, në Krumë, në Kukës apo edhe në Tiranë e nuk mbjellin e as korrin, as grurë e as misër. Këto subvencione vijnë duke u ulur çdo vit, nuk arrijnë t'i marrin fermerët e Veriut të vendit. Paratë e subvencioneve shkojnë për ata që janë në listat e partisë dhe jo te fermerët e ndershëm.

Pozita gjeografike, distanca me kryeqytetin dhe mungesa e mbështetjes bën që çdo produkt, që shkon te konsumatori, pra te këta qytetarët e varfër, të ketë një kosto shumë më të lartë se në zonat e tjera. Prandaj ky buxhet është buxheti i varfërimit për ta, se, po të ishte ndryshe, do të kishim investimet e duhura për këtë trevë të varfër, që mundësitë e punësimit në sektorin privat i ka shumë të pakta. Ky buxhet bëhet edhe më varfërues për Tropojën, Hasin e Kukësin, nga mungesa e investimeve në infrastrukturën rrugore, që e bën këtë qark më të izoluarin. E dini pse? Sepse realisht nuk ka pasur investime të qëndrueshme që prej vitit 2013.

Situata më e mjerë është në infrastrukturën rurale, ku investimet kanë qenë pothuajse zero; po, po zero! A e di qeveria se shumica e banorëve të fshatrave të Tropojës lëvizin lirshëm në rrugë vetëm në 3 muajt e verës, pasi me shiun e parë ose me borën e parë rrugët bllokohen, e për rrjedhojë banorët mbeten të izoluar dhe detyrohen të kthehen si në mesjetë për të siguruar transportin e ushqimeve dhe të njerëzve? Imagjinoni kur kanë raste urgjence ose me të sëmurë dhe rrezikojnë jetën, pasi nuk kanë mundësi të dalin normalisht në qytet! Shumë rrugë janë të painvestuara prej vitesh, por ka edhe raste si aksi Kam-KepenekZogaj-Qafë Prush, i cili është një ndër rrugët më të vjetra në Shqipëri, ndërtuar nga italianët që në vitin 1930, e cila, përveçse u shërben banorëve të fshatrave të Tropojës e Hasit, i lidh këto zona me pikën doganore të Qafë-Prushit dhe me Kosovën. Projekti i saj, i përfunduar këtu e 8 vjet më parë, fle sirtarëve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe të ARRSH-së, duke u bërë slogan premtimesh e gënjeshtresh në fushatat e elektorale. Secili prej kandidatëve të rilindjes, sa herë ka kërkuar votat e banorëve të kësaj zone, ka premtuar investimin nga buxheti i radhës, por në asnjë rast nuk janë kujtuar më për ta kërkuar një investim të tillë. A e dini pse nuk investoni ju në infrastrukturën

e Tropojës? Unë them ngaqë ata nuk votojnë për ju. Në çdo fushatë ju i gënjeni e pastaj në shenjë hakmarrjeje i lini në mungesë investimesh dhe në varfëri. Po ashtu, nga mungesa e investimit, në gjendje të mjeruar është edhe rruga e fshatit Degë, që është një ndër fshatrat më të banuar dhe banorët e tij jetojnë kryesisht me blegtori dhe bujqësi. Ata janë të detyruar që prodhimet e tyre dhe ushqimet për bagëtitë dhe familjet t'i transportojnë me një kosto shumë të lartë, sepse rruga është tejet e amortizuar. E tillë paraqitet gjendja e rrugëve dhe në njësinë administrative Nikaj-Mërtur, e cila është një zonë me bukuri natyrore dhe me përparësi për zhvillimin e turizmit, si: Curraj i Epërm, Vrana, Salca, lugina e bregut të liqenit e të tjera. E njëjta gjendje është edhe në rrugët e fshatrave Kasaj, Kërrnajë, Gegaj, Lugu i Tropojës, Luzhë, Gri, Vlad, Berishë, Zherkë, Velisht, Çerem, Unaza e Bjeshkëve e të tjera. Po ashtu, në Has janë në gjendje të mjerueshme rrugët: Fajza-Gjinaj-Domaj, Helshan-Kostur, Golaj-Doruntinë, që lidhet me Gjakovën, Krumë-Cahan-Kishaj, që lidhet me Prizrenin. Në buxhetin tuaj zhvillimi rural do të ketë 2,7 milionë euro më pak ose 9%, çka do të thotë vazhdim i mjerimit për këto zona.

Ju, zoti Kryeministër, keni lajmëruar se në mars do të lëshoni satelitin e parë shqiptar në hapësirë. Lëshoje pa merak, pasi Tropojën nuk do ta skanojë dot nga lart, sepse në shumicën e kohës nuk ka energji elektrike. Madje, as nuk do ta shohin dot show-n ditën kur të shtypësh butonin që ëndërron ti. Në Tropojë ka mungesë pothuajse totale të investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Kabinat janë të rrënuara, shtyllat e drurit të kalbura dhe transformatorët nuk janë zëvendësuar prej vitesh dhe linjat e transmetimit janë ato të vitit 1970. Megjithëse jemi rrethi i dytë në nivel vendi për sa i takon prodhimin të energjisë, tropojanët vuajnë mungesën e madhe të energjisë në shtëpitë e tyre, pavarësisht se i paguajnë rregullisht faturat e energjisë. Ku shkojnë këto para? Pse nuk u kthehen banorëve në investime? Kemi dëgjuar prej jush, zoti Kryeministër, se keni bërë investimet më të mëdha në sistemin energjetik, por në Tropojë, përveç makinave të reja për drejtuesit e OSSHESë dhe HEC-it të Fierzës, nuk ka asnjë investim të rëndësishëm. Në Has janë mbyllur miniera në Vlahën dhe fabrika në Perollaj, duke nxjerrë shumë njerëz pa punë. Asnjë subvencion në bujqësi, pemëtari e blegtori, ndërsa shkollat në Golaj e Vlahën janë pa asnjë lloj kushti për mësim, çka ka bërë që familje të tëra në Tropojë, Has e Kukës të ikin përditë, pasi kanë humbur shpresën për të jetuar vendin e tyre. Një mungesë tjetër në buxhetin tuaj të varfërimit për këta banorë është mungesa e investimeve në sistemin e kanaleve të vaditjes, pasi ato janë të dëmtuara nga faktorët natyrorë, si dhe të amortizuar nga koha, pra nga mungesa e investimeve serioze në to. Projektet ekzistojnë, por ato kanë nevojë për financim nga qeverisja qendrore. Në harkun kohor të dy viteve të fundit, qarku i Kukësit ka numrin më të lartë të vizitorëve, turistë këta që kanë hyrë në Shqipëri në rrugë tokësore. Pra, ky numër është mjaftueshëm që turizmi malor i këtij qarku të jetë një ndër prioritetet absolute të qeverisë tuaj.

Në fakt, në këtë projektbuxhet, në programin "Zhvillimi i turizmit" me fondet e buxhetit të qeverisë, nuk ka asnjë projekt konkret të parashikuar për këtë zonë. Projektet e paraqitura nga ana juaj në fushatat e zgjedhjeve elektorale kanë mbetur në 3D. Resortet e papara të skive në zonën e Shishtavecit, si dhe hanet e bujtinat në zonat e bjeshkëve të Hasit, Kukësit e Tropojës janë vetëm në 3D, premtime imagjinare tuajat dhe të të dërguarve tuaj në këtë qark. Me këtë projektbuxhet mund t'i jepnit një hov zhvillimit të turizmit me ndikim direkt në ekonominë dhe punësimin e banorëve të këtij qarku, nëse këto projekte do të financoheshin. Gjithashtu, ky projektbuxhet nuk adreson shqetësimin e ligjshëm të banorëve të Tropojës për decentralizimin e disa shërbimeve shumë të domosdoshme për ta, të cilat janë të detyruar t'i marrin në qytetin e Kukësit dhe në prefekturën e këtij qarku. Me keqardhje konstatoj se asnjë investim nuk është parashikuar në këtë projektbuxhet për sa i përket punësimit dhe alternativave të tjera. Zoti Kryeministër, ato çfarë kërkojnë banorët e Tropojës, Hasit e Kukësit janë tri gjëra bazike: rrugë, energji elektrike dhe ujë, që Perëndimi dhe Europa e emancipuar, ku jemi nisur të shkojmë, ka mbi 100 e kusur vjet që i ka zgjidhur. Ju u flisni

atyre për satelitë, për “Albania 1” e “Albania 2”! Folu sa të duash, por siguroju gjërat bazike që kërkojnë. Faleminderit!